

Peauçës Revue
29/09/2022

KUVENDI
NR 3196 DATE 28.09.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2022

Lënda: Depozitim projektligji nga një grup deputetësh të PDSH

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit








Zonja Kryetare,










Me anë të kësaj shkrese, ne deputetët e poshtënuar të PDSH, në mbështje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit, po depozitojmë Projektligjin “Për pastërtinë e figurës së funksionarit dhe të zyrtarit publik”, së bashku me relacionin shoqërues (shkresa bashkëngjitur).

Ju lutem të gjeni bashkëngjitur edhe listën me emrat dhe firmat e nënshkruesve.

Ju faleminderit.

Ornel Bylyke Kodra

1. Derel Bylykbashtu 
2. Tewor Aliosti 
3. BELIND KËLISI 
4. Spennu Noka 
5. Sali Bursko 
6. LUCIANO BOSI 
7. Albano Vashi 

8. EDI PALOKA 
9. Edmund Spaho 
10. AGRON SHERAJ 
11. Tilita Shetu 
12. Eida Hoti 
13. ISUF ÇELAJ 
14. Luan Baci Luni 
15. Ina Zhupo 
16. Bijar Veshtaj 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2022

PËR

PËR PASTËRTINË E FIGURËS TË FUNKSIONARIT DHE TË
ZYRTARIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 6/1, 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim që të garantojë besimin e publikut në funksionimin e institucioneve shtetërore duke verifikuar pastërtinë e figurës të funksionarëve dhe të zyrtarëve të lartë publikë në Republikën e Shqipërisë, të zgjedhur apo të emëruar, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre në strukturat e sistemit politik të diktaturës komuniste, përfshirë por pa u kufizuar me strukturat e dhunës dhe ato të ish-Sigurimit të Shtetit, për periudhën nga data 29 nëntor 1944 deri në datën 8 dhjetor 1990.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi se cilët subjekte dhe/ose funksione të larta publike dhe shtetërore, do të jenë të papajtueshme me veprimtarinë publike të

funksionarit dhe zyrtarit të lartë në Republikës së Shqipërisë, për shkak të genies anëtar, drejtues apo bashkëpunëtor në strukturat politike apo zbatuese të dhunës së diktaturës së proletarietit, apo të ish-Sigurimit të Shtetit, për periudhën nga data 29 nëntor 1944 deri në datën 8 dhjetor 1990, duke përcaktuar rastet e papajtueshmërisë, procedurat e kontrollit, si dhe pasojat eventuale në rast konstatimi të papajtueshmërisë.

Neni 3 **Subjektet e verifikimit**

Subjekte të verifikimit do të jenë të gjithë funksionarët e lartë publikë, pavarësisht nëse janë të zgjedhur apo të emëruar, të cilët aktualisht ushtrojnë apo do të ushtrojnë në të ardhmen, një nga funksionet e mëposhtme:

- a) Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- b) deputetët e Kuvendit të Shqipërisë;
- c) anëtarët e Këshillit të Ministrave, zëvendësministrat, funksionarët politikë, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive të dikastereve, si dhe të barazuarit me ta në institucionet e tjera shtetërore qendrore ose të pavarura;
- ç) anëtarët e Këshillit të Lartë të Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, përfshirë anëtarët e bordit dhe pedagogët e Shkollës së Magjistraturës, si dhe gjyqtarët e prokurorët pranë gjykatave dhe prokurorive të të gjitha niveleve;
- d) guvernatorë, zëvendësguvernatorë, anëtarët e bordit dhe drejtorët e Bankës së Shqipërisë;
- dh) funksionarë e lartë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, si dhe oficerët me gradë “Gjeneral” dhe “Kolonel”;
- e) prefektët, kryetarët e këshillave të qarkut, si dhe kryetarët e bashkive dhe komunave;
- ë) drejtuesit e drejtorive të administratës publike në nivel qarku;
- f) drejtuesit e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), të Shërbimit Informativ Ushtarak (SHIU) dhe të çdo shërbimi tjetër inteligjent, përfshirë drejtorët e këtyre shërbimeve;
- g) drejtuesit e Gardës së Republikës;
- gj) funksionet e larta drejtuese në Policinë e Shtetit, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, deri tek drejtuesit në nivel qarku dhe komisariati, përfshirë drejtuesit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- h) drejtuesit e përfaqësive diplomatike;
- i) Kryetari dhe anëtarët e Akademisë së Shkencave, rektorët, zëvendësrektorët dhe dekanët në universitetet publike;
- j) Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Publik Shqiptar, si dhe anëtarët e këshillave drejtues të medieve publike;

k) çdo person tjetër i dekretuar nga Presidenti i Republikës apo i zgjedhur nga Kuvendi.

Neni 4 **Testi i pastërtisë së figurës**

1. Nuk e kalojnë testin e pastërtisë së figurës morale për të qenë funksionarë të lartë publikë të Republikës së Shqipërisë, të zgjedhur apo të emëruar, të gjithë ata persona mbajtës së funksioneve të renditura në nenin 3 të këtij ligji, të cilët, gjatë periudhës 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990, kanë mbajtur një nga detyrat apo cilësitë e mëposhtme:

a) anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare apo është larguar vetë nga detyra në mënyrë publike;

b) anëtarët e Presidiumit të Kuvendit Popullor;

c) Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm dhe Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme;

ç) Ministër, Zëvendësministër i Punëve të Brendshme, kryetarët e degëve të punëve të brendshme, si dhe çdo punonjës i organeve të Sigurimit të Shtetit;

d) personat që kanë mbaruar shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme në profilin e Sigurimit, ose kanë kryer kurse tremujore e lart po në këtë profil, ose në analoget e tyre brenda apo jashtë shtetit dhe që kanë punuar si hetues, prokurorë apo gjyqtarë, pa qenë të diplomuar "jurist";

dh) i dënuar me vendim penal të formës së prerë për krime kundër njerëzimit ose për veprat penale të shpifjes, të kallëzimit të rremë ose dëshmisë së rreme në procese politike;

e) bashkëpunëtor i organeve të Sigurimit të Shtetit me veprimtari të karakterit politik, që lidhen me veprat penale politike të parashikuara nga ligji nr.7514, datë 30.09.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar, apo bashkëpunëtor vullnetar për vepra të tilla;

ë) anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve;

f) hetues, prokuror ose ndihmësprokuror, gjyqtar apo ndihmësgjyqtar në procese politike;

g) denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset gjyqësore politike.

2. Për të gjithë personat që nuk e kalojnë testin e pastërtisë së figurës morale, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni, kjo rrethanë do të konsiderohet që cënon integritetin e funksionarit publik, dhe do të konsiderohet e papajtueshme mbajtja e detyrave të funksionarit publik të Republikës së Shqipërisë, të zgjedhur apo të emëruar.

Neni 5

Konflikti i interesit

Asnjë person që ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë së funksioneve, sipas nenit 4 të këtij ligji, nuk mund të marrë pjesë në asnjë pozicion në autoritetin e përcaktuar sipas këtij ligji, si dhe nuk mund të jetë pjesë në trupa gjyqësorë që marrin në shqyrtim këtë ligj ose çështje që lidhen me zbatimin e tij.

KREU II

AUTORITETI I KONTROLLIT TË FIGURËS

Neni 6

Autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës

1. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji do të kryhet nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ngritur nëpërmjet Ligjit Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “Autoriteti”).
2. Autoriteti organizohet dhe funksionon në mënyrë të pavarur, sipas rregullave të përcaktuara në ligjin organik, këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit.
3. Autoriteti ka për detyrë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë pastërtinë e figurës të funksionarëve publikë, të zgjedhur apo të emëruar, sipas kriterëve të këtij ligji.
4. Brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Autoriteti miraton formularin tip të vetëdeklarimit të parashikuar në këtë ligj.

Neni 7

Kushtet dhe kriteret e anëtarëve të Autoritetit

1. Anëtar i Autoritetit mund të zgjidhet personi që:
 - a) ka shtetësi shqiptare;
 - b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) ka mbaruar arsimin e lartë, me Diplomë “Master shkencor”, ose tituj të ekuivalentuar me të;
 - ç) gëzon integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;
 - d) ka jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit;
 - dh) nuk ka qenë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
 - e) nuk është anëtar në parti politike;
 - ë) në periudhën e përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së

Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkë-punëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Interni-meve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike, të posaçme;

f) nuk ka konflikt interesi me detyrën;

g) plotëson kushtet, kriteret dhe pajiset me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Çdo kandidat për anëtar, përpara emërimit të tij, nënshkruan një deklaratë për mosmbajtjen prej tij të asnjë prej detyrave apo cilësive të përcaktuara në shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Qenia anëtar i Autoritetit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore apo private.

Neni 8

Vetëdeklarimi i pastërtisë morale

Anëtarët e Autoritetit në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të bëjnë një deklaratë për pastërtinë e figurës, lidhur me papajtueshmërinë e funksioneve, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 9

Verifikimi i pastërtisë morale të kandidatit për anëtar

1. Në rast vakance në anëtarësinë e Autoritetit përgjatë periudhës së zbatimit të këtij ligji, çdo kandidat do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të pastërtisë së figurës, sipas kriterëve të këtij ligji.

2. Ky verifikim do të kryhet nga vetë Autoriteti brenda 15-ditëve nga marrja e njoftimit të propozimit nga Kuvendi.

3. Rezultatet e verifikimit të anëtarëve të Autoritetit bëhen publike nga Kuvendi.

Neni 10

Përfundimi i mandatit të anëtarit të Autoritetit

1. Mandati i anëtarit të Autoritetit mbaron sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 11

Sekretariati teknik

1. Autoriteti, gjatë veprimtarisë së tij, mbështetet nga sekretariati teknik, i cili

krijohet dhe vepron sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU III

PROCEDURA E KONTROLLIT DHE E VERIFIKIMIT TË FIGURËS

Neni 12

Fillimi i procesit të verifikimit

Për të gjithë subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, Autoriteti fillon procedurën e verifikimit të pastërtisë të figurës së funksionarëve:

- a) me kërkesë me shkrim të titullarit të institucionit apo organit të emërtesës së tij, për funksionarin publik, përpara sesa ai të emërohet;
- b) me kërkesë të vetë subjektit, ose të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kur ai kandidon në një proces zgjedhor; ose
- c) kryesisht.

Neni 13

Vetëdeklarimi i subjekteve

1. Çdokush që mban një nga funksionet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji është i detyruar që brenda 60-ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të depozitojë tek Autoriteti vetëdeklarimin për kontrollin e pastërtisë së figurës. Vetëdeklarimi përmban edhe kërkesën për vefikimim. Vetëdeklarimi plotësohet dhe nënshkruhet personalisht nga subjekti. Mosdorëzimi i vetëdeklarimit brenda afatit passjell përfundimin e funksionit sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.

2. Kandidatët për emërimë apo zgjedhje në një nga funksionet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, i nënshtrohen procesit të verifikimit të figurës nga Autoriteti, pa penguar me vijimin e emërimit të tyre.

3. Në rastin e të zgjedhurve në Kuvend dhe në organet e qeverisjes vendore, procedura e verifikimit të kandidatëve që konkurrojnë do t'i nënshtrohen verifikimit të figurës me përparësi.

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk e regjistron kandidatin në rast se ky i fundit nuk paraqet kopje të vetëdeklarimit drejtuar Autoritetit për t'u pajisur me dëshminë e verifikimit.

Neni 14

Thirrja e mbledhjes për procedurën e verifikimit

Kryetari i Autoritetit ose, në mungesë të tij, anëtari më i vjetër, thërret mbledhjen për procedurën e verifikimit brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për verifikim nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 15

Rregullat e mbledhjes së Autoritetit

1. Autoriteti kryen procedurat e verifikimit dhe kontrollit të pastërtisë morale të figurave, nën drejtimin e kryetarit të tij dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër.
2. Për çdo kërkesë për fillimin e procedurës së verifikimit ose për çdo rast të marrë në proces verifikimi kryesisht nga vetë Autoriteti, hapet një dosje e veçantë, në të cilën ruhen:
 - a) kërkesa dhe vetëdeklarimi;
 - b) çdo akt dokumentues i veprimtarisë verifikuese;
 - c) çdo akt i llojit dokument i marrë në këtë proces.
3. Mbledhja e Autoritetit është e vlefshme kur në të marrin pjesë kuorumi prej të paktën 4 nga 5 anëtarë.
4. Në çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili kontrollohet për saktësi nga kryetari dhe, në mungesë të tij, nga zëvendëskryetari. Në përfundim të mbledhjes, ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë.
5. Autoriteti njofton subjektin e interesuar për t'u dëgjuar në seancë degjimore, përpara se Autoriteti të marr vendim për rastin e tij. Me kërkesë të subjektit, seanca degjimore zhvillohet me dyer të mbyllura.
6. Në çdo rast, procedura e verifikimit duhet të përfundojë si rregull brenda 30 ditëve, por jo më vonë se 60 ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës për verifikim ose nga data e fillimit kryesisht të procedurës së verifikimit.

Neni 16

Papajtueshmëria dhe konflikti i interesave

1. Në fillim të mbledhjes për verifikimin e figurës së çdo funksionari apo zyrtari, anëtari i Autoritetit nënshkruan një deklaratë për mungesën e papajtueshmërisë ose të konfliktit të interesit midis tij dhe subjektit nën verifikim.
2. Çdo anëtar i Autoritetit ka detyrimin të paraqesë në mbledhje çdo rrethanë papajtueshmërie apo konflikti interesash që ndonjë anëtar tjetër i Autoritetit ka me subjektin nën verifikim.

3. Anëtari i Autoritetit është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të figurës së funksionarit, në çdo rast që ekzistojnë shkaqe të rëndësishme të papajtueshmërisë apo konfliktit të interesave midis tij dhe subjektit nën verifikim, të tilla që ndikojnë qëndrimin e tij në procedurën e verifikimit. Dorëheqja shqyrtohet dhe pranohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Autoritetit.

4. Në rastin kur anëtari i Autoritetit, ndonëse ka detyrimin, nuk heq dorë nga pjesëmarrja, përjashtimi i tij vendoset nga mbledhja e Autoritetit, pasi është dëgjuar paraprakisht anëtari.

Neni 17

E drejta për të kërkuar të dhëna

Në funksion të realizimit të detyrave të ngarkuara me këtë ligj, Autoriteti ka të drejtën të kërkojë t'i vihen në dispozicion të gjitha materialet arkivore, duke përfshirë edhe dokumentacionet e ish-Partisë së Punës të Shqipërisë, nga të cilat mund të merren të dhëna për veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të personave të veçantë, që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

Neni 18

Votimi

1. Çdo anëtar i Autoritetit ka detyrimin që të shprehet me votë, pro ose kundër, si dhe detyrimin për të motivuar votën e dhënë. Abstenimi nuk lejohet.

2. Vota e anëtarit në pakicë dhe arsyet e këtij votimi shënohen në procesverbal.

3. Dëshmia e verifikimit për subjektin e verifikuar lëshohet kur kanë votuar pro të paktën 3 anëtarë të Autoritetit.

4. Brenda dy ditëve nga mbledhja, kryetari i Autoritetit lëshon dëshminë që pasqyron rezultatin e procedurës së verifikimit të pastërtisë morale të funksionarit.

Neni 19

Rezultatet përfundimtare të procedurës së verifikimit

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit, Autoriteti:

a) Kur rezulton se subjekti i verifikuar është i papërfshirë në veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, merr vendim për lëshimin e dëshmisë së pastër të figurës morale dhe publikon vendimin. Kjo dëshmi nënshkruhet nga kryetari dhe i komunikohet subjektit të verifikuar dhe/ose institucionit kërkues të procedurës së verifikimit.

b) Kur rezulton se subjekti i verifikuar është i përfshirë në veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, merr vendim që të lëshojë dëshminë e verifikimit të figurës morale dhe publikon vendimin. Kjo dëshmi, e nënshkruar

nga kryetari, i njoftohet subjektit të verifikuar dhe institucionit kërkues të procedurës së verifikimit. Pas marrjes së dëshmisë, sipas kësaj shkronje, subjekti i verifikuar ka të drejtë të njihet me aktet e përfshira në dosjen e tij pranë Autoritetit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2. Kur zyrtari nuk është dakord me vendimin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, ai ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 20

Vlera e dëshmisë së verifikimit

Dëshmia e verifikimit ka fuqi të plotë provuese mbi faktin e pastërtisë së figurës së çdo funksionari publik të zgjedhur apo të emëruar.

KREU IV

VEPRIMET E ORGANEVE KOMPETENTE KUR VERIFIKOHEN KUSHTET E PAPAJTUESHMËRISË

Neni 21

Veprimet e KQZ, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit

1. Kur, pas përfundimit të kontrollit të Autoritetit verifikohen kushtet e papajtueshmërisë, në përputhje me këtë ligj, KQZ kryen veprimet e mëposhtme:

a) refuzon kandidaturën e personit, kur kushtet verifikohen para procesit të pranimit të kandidaturave, dhe i kërkon subjektit zgjedhor të interesuar të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave;

b) heq kandidatin nga kandidimi kur kushtet verifikohen para shtypjes së fletëve të votimit pa të drejtë zëvendësimi për rastin e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore apo për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e njësisë së qeverisjes vendore;

c) kur kushtet e moskandidimit verifikohen pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultateve:

i) shpall pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje të personit që ka të drejtën e mandatit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, mbi bazën e votave të marra;

ii) shpall rezultatin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, sipas këtij neni, për një kandidat që nuk është fitues, dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës;

iii) përjashton nga përlllogaritja e mandateve kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për këshilltar në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse

- dhe përlogarit mandatet, duke përjashtuar votat e marra prej tij;
- iv) shpall fitues nga lista shumemërore kandidatin vijues në renditje dhe në përputhje me kuotën gjinore, si dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës;
- ç) shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor;
- d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës, si dhe shpall mandatin në përputhje me këtë Kod, si dhe njofton Kryetarin e Kuvendit, në rastin e pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, apo Kryeministrin, në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.
2. Kur deputeti mban në të njëjtën kohë postin e anëtarit të Këshillit të Ministrave, Kryeministri i propozon Presidentit, brenda 48 orëve, shkarkimin e ministrit.
3. Në rast se kushtet e pavlefshmërisë së mandatit verifikohen për Kryeministrin, ai i paraqet Kuvendit mocion besimi, brenda 48 orëve, në përputhje me nenin 104 të Kushtetutës, dhe Kuvendi miraton shkarkimin e tij nga detyra.
4. Në rast se anëtari i Këshillit të Ministrave nuk ka mandat deputeti, konstatimi i papajtueshmërisë, në përputhje me këtë ligj, zbatohen sipas rastit, pika 2 ose 3 e këtij neni.
5. Në rastet kur organet e ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, nuk veprojnë brenda 10 ditëve nga përfundimi i rezultateve të verifikimit, me kërkesë të 1/5 së deputetëve të Kuvendit, çështja i përcillet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, e cila vendos konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, kur plotësohen kushtet dhe rrethanat, sipas këtij ligji.

Neni 22

Rastet e krijimit të vakancave në Kuvend ose këshillin bashkiak

1. Kontrolli dhe verifikimi i figurës, në përputhje me këtë ligj, kryhet edhe për çdo kandidat të listave shumemërore apo kandidat të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin apo këshillin bashkiak përkatës, kur, për shkak vakance në Kuvend apo në këshillin bashkiak, kandidatit i takon të marrë mandatin për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.
2. Për kandidatët e listave shumemërore, për të cilët kryhet verifikimi, sipas

pikës 1, të këtij neni, kur verifikohen kushtet e moszgjedhshmërisë, sipas këtij ligji, KQZ-ja shpall faktin e moszgjedhshmërisë së personit përkatës dhe procedon me kandidatin vijues, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Neni 23

Përfundimi i ushtrimit të funksionit publik për funksionarët publikë të emëruar

1. Kur, pas përfundimit të kontrollit të Autoritetit, verifikohen kushtet e papajtueshmërisë nga ky ligj për kategoritë e tjera të funksionarëve publikë të emëruar, përjashtuar Presidentin e Republikës, deputetët, anëtarët e Këshillit të Ministrave, apo kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiakë, Autoriteti, shpall publikisht rezultatin e verifikimit. Në këtë rast, mandati apo funksioni përfundon menjëherë për shkak të ligjit.
2. Në rastin e organeve kushtetuese apo të krijuara me ligj të sistemit të drejtësisë, Autoriteti merr masa për publikimin e rezultatit të verifikimit në numrin më të parë të Fletores Zyrtare dhe përfundimi i mandatit apo detyrës të këtyre subjekteve shpallet sipas rastit nga organi i tyre i emërtesës apo i kontrollit, në mbledhjen më të afërt.
3. Në rastin e organeve të tjera kushtetuese apo të krijuara me ligj, Autoriteti merr masa për publikimin e rezultatit të verifikimit dhe përfundimin e mandatit apo detyrës në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.
4. Në rastet e ndryshme nga ato të parashikuara nga pika 3 e këtij neni, organi kompetent merr masa për njoftimin e personit, të cilit i përfundon detyra, dhe ndjek procedurat për zbatimin e masave të përcaktuara nga ky ligj.
5. Në rastet kur organet e ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, për rastet e parashikuara nga pika 2 e këtij neni, nuk veprojnë brenda 10-ditëve nga publikimi i rezultateve të verifikimit në Fletoren Zyrtare, me kërkesë të 1/5 së deputetëve të Kuvendit, çështja i përcillet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, e cila vendos sipas rastit, konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik.

Neni 24

Pasojat e refuzimit të vetëdeklarimit

Në rast refuzimi për të dorëzuar vetëdeklarimin nga subjektet e ngarkuara nga ky ligj, personi trajtohet sikur të ketë rezultuar në një nga rrethanat e papajtueshmërisë që përbën kusht për ndalim e zgjedhjes apo emërimit të tij në funksionin publik. Sipas rastit, ndaj tij zbatohet masa e parashikuara në Kreun IV të këtij ligji lidhur ndalimin e kandidimit ose emërimit, ose të përfundimit të

funksionit.

Neni 25

Transparenca me publikun

1. Autoriteti krijon një regjistër elektronik për të gjitha rastet e verifikuara dhe publikon në faqen e vet zyrtare informacion për numrin e rasteve të verifikuara. Ky informacion përditësohet çdo javë.
2. Autoriteti bën publike në faqen zyrtare identitetin e të gjithë zyrtarëve të kualifikuar si të papajtueshëm për të vazhduar detyrën, për të cilët nuk është zhvilluar procedura e skualifikimit, apo nuk ka përfunduar marrëdhënia e punës, sipas këtij ligji.

Neni 26

E drejta për t'u njohur me dosjen personale

1. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të njihet pa pengesë me dokumentat dhe çdo informacion tjetër personal, që përmbajnë dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit për të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar.
2. Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Funksionimit të Autoritetit.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Verifikimi i figurës së zyrtarëve në detyrë

Autoriteti, sipas radhës së përparësisë së përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, brenda 180-ditëve nga fillimi i funksionimit të tij, përfundon me përparësi verifikimin e pastërtisë së figurës së çdo funksionari të lartë shtetëror në detyrë.

Neni 28

Afati kohor i veprimtarisë së Autoritetit

1. Veprimtaria e Autoritetit, sipas këtij ligji, vazhdon deri më 31 dhjetor 2027.
2. Kuvendi, brenda 30-ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton ndryshimet në Rregulloren e funksionimit të Autoritetit për t'a përshtatur atë me parashikimet e këtij ligji. Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe mënyra e ndarjes së përgjegjësisë dhe e komunikimit ndërmjet Autoritetit dhe sekretariatit teknik të tij.

Neni 29

Rishikimi i vendimeve të mëparshme të verifikimit të figurës

Për personat që është lëshuar më parë një dëshmi për verifikimin e figurës, sipas ligjeve të kohës, rishikimi i vendimit me të cilin është lëshuar dëshmia mund të kryhet vetëm nga Gjykata e Lartë.

Neni 30

Dispozitë kalimtare

Dispozitat e këtij ligji janë të barasvlershme me dispozitat e Kodit Zgjedhor, ligjit për nëpunësin civil dhe ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përfshihen nga veprimi i këtij ligji. Në rast konflikti midis normave, dispozitat e këtij ligji kanë përparësi.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA